



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr. 5974/2019  
Data: 08.07.2019

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e gjashtë - VI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.06.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emërgjencë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Finaca), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstataoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i kornizës afatmesme buxhetore 2020-2022.
3. Miratimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë.
4. Informatë për sektorin e emergjencave.
5. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- nuk e kam parë as në rregullore të punës, as në statut as në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nuk thuhet se kuvendi i komunës merret me informata. Është mirë që të përdoret një shprehje tjetër. Para tri mbledhjeve kam propozuar një pikë të rendit të ditës që të debatohet në kuvend për nepotizmin familjarë dhe politik apo militantizmi në komunë. E kam dëgjuar herën e parë kryesuesin e kuvendit të komunës i cili potencoi që është mirë të bisedohet prej vitit 1999 -2000 dhe ju i nderuar kryesues keni shkuar pak larg prej vitit 1999 dhe nëse është fjala për te unë nuk kam qenë i zgjedhur me vota të qytetarëve në Terminal por kam qenë i pranuar në marrëdhënie të punës dhe i kam pasur eprorët e mi. Unë kërkova vetëm për ekzekutivin se a ka nepotizëm dhe nëse nuk ka nuk debatojmë por nëse nuk ka nuk debatojmë, mirëpo unë konsiderojë që ka. Vërejta që ka disa veprime që doni ta pengoni diskutimin apo debatin në forma të pyetjeve. Nëse ju konsideroni që nuk ka dhe jenit të kënaqur me punë unë e tërheq propozimin tim.

Kryesuesi thekson:- sa i përket pikave të rendit të punës që potencove që janë si informata si grup për hartimin e planit të punës i kemi lënë në këtë mënyrë me shefat e grupeve parlamentare dhe është miratuar në kuvendin e komunës ky plan. Informatat nuk miratohen dhe në muajin tjetër e kemi formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës dhe vërejtjet e juaja mundemi me i diskutuar. Unë atë ditë kam diskutuar dhe secili i ka mendimet e veta dhe jam përmendë me diskutuar nepotizmin në tërsi e jo me periudha. Te nepotizmi jam përmendë me dal me emra për shkak se nëse mendoni se unë e kam sjellur dikend du që me emër të ma përmendni në mënyrë që ta dijë që brenda dhjetë viteve kënd e kam sjell unë. Unë nuk dua me akuzuar në përgjithësi që ty e ke dërguar këtë por konkret sepse nepotizmi është që secili në komunë me pa ndikimin e vetë se sa ka sjell persona. Unë dua konkretë me emër me ma përmendë dhe mbajë përgjegjësi nëse dikend e kam këtu por jam me dal konkret me emra sepse personale nuk kam asgjë me askënd. Unë propozimin e qes në votim dhe nëse kalon e diskutojmë si pikë të rendit të punës por minden me diskutuar edhe te të ndryshmet .

**Mefail Suma** thekson:- unë e them mendimin tim të cilin ma kanë përcjell të tjerët sepse mos mendoni që asambleisti është në komunë vetëm me përmendur emra për shkak se secili e përfaqëson një parti politike për mbledhjen e kaluar nga z.Akif Shkreta që janë organet e tjera të cilat merren me nepotizëm, mirëpo më shumë më për ajo që u potencua vitin 1999 dhe nëse fillojmë prej atij viti hapet shumë dhe nuk mund ta kishim mbyllur për një ditë debatin.

**Kryesuesi** thekson:- ndoshta hapet debati por dhjetë vite kam qenë pa punë në atë kohë kështu që jam për me diskutuar.

**Akif Shkreta** thekson:- për pikat që i potencoja për rendin e ditës që janë shënuar si informata unë mendojë që mund të precizohen si njoftim. Sa i përket çështjes së dytë e cila po na përcillet edhe në këtë seancë është tema shumë e personalizuar në mes të Kryesuesit të Kuvendit dhe z.Mefail Suma gjë që nuk është në rregull për shkak se unë mendoj që është rruga ligjore dhe propozohet pika kalon diskutohet dhe mund të vazhdohet edhe në seancën tjetër. Kjo mënyrë e diskutimit në mbledhjen e kaluar nuk na shpien në ndonjë rezultat konkret por duhet ta ndjekim rrugën ligjore për shkak se nëse fillojmë t'i kthehem historisë, krijo një koncept propozo pikë qite në miratim dhe nëse kalon mund të diskutojmë. Jemi legjislativ dhe konsideroj që duhet t'i respektojmë rregullat tonë sepse me njëfarë mënyre po bisedojmë dhe nuk po arrijmë me ndonjë rezultat.

**Florim Shkreta** thekson:- çështjen e nepotizmit si kryesues i kuvendit e ke marr pak si personale për shkak se nuk je i vetmi ti që ishe pa punë dhe ndoshta ka mundur dikush me ta bërë të padrejtë dhe nuk dua të hyjë andej, mirëpo të paktën këtu në kuvend mos i diskuto gjërat pse mu ma ka bërë dikush dhe tash më ka ardhur një mundësi me ja bërë dikujt tjetër. Nuk ka asgjë të keq pse hynë në rend të ditës kjo pikë për me u diskutuar dhe nuk besoj që është ndonjë problem i madh. z.Akif Shkreta potencon që kjo është punë e votës, mirëpo kjo pikë nuk është diçka që juve ju pengon për shkak se ju mendoni se gjërat janë mirë.

**Akif Shkreta** thekson:-çështja është që të ndiqet rruga ligjore e futjes së një pike të rendit të punës në seancë të kuvendit të komunës. Ne po diskutojmë për të njëjtën pikë dhe po humbim një orë për të njëjtën pikë të rendit të punës dhe nuk ka ndonjë rezultat.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë mendoj që nepotizmi do të ishte mirë me u diskutuar si dukuri ose fenomen por jo me rënë në aspektin personal se besoj që dalin telashe të mëdha dhe keqkuptime shumë të mëdha te njëri tjetri sepse secili e ka një pakënaqësi dikund, secili e ka një pretendim dikund, secili e ka një dyshim dikund. Më mirë është si dukuri mos me ndodhë dhe a kemi mundësi ne me luftuar këtë dukuri por jo me emra të veçantë siç po potencon ti si kryesues i kuvendit të komunës për shkak se mund të ndodhë një urrejte në mes vete në Han të Elezit. Unë propozoj që të diskutohet te pika të ndryshme kush ka të diskutojë për nepotizmin por jo me ra në nivelin personal të gjëra sepse ka pakënaqësi gjithkush.

**Isni Bushi** thekson:- nëse ka ndonjë pakënaqësi që mendojnë qytetarët që ka konkurruar dikush dhe nuk është pranuar janë rrugët ligjore. Si kuvend mund ta diskutojmë por a mundemi me marr ndonjë vendim për shkak se nuk i kemi ato kompetenca. Ne edhe në familjet tona nuk i kemi të gjithë të kënaqur dhe personat mund të flasin prej këndeve të ndryshme dhe arsyeve të ndryshme , mirëpo janë organet dhe ti paraqesin dhe shohin vetën e tyre se kush është gabim. Nuk e shohë të arsyshem që të diskutohet për shkak se janë organet ne të vazhdojnë me procedura.

**Florim Shkreta** thekson:- parafolësi potencon se janë pikërisht këtu është problemi se organet të cilat janë të parapara për këto konkurse nuk merren ashtu siç duhet. Kur potencon një arsimtarë se është krejt në rregull mendoj se është për të ardhur keç. Këto dukuri janë të dëmshme për vendin tonë për shkak se nuk është problemi se pse e punëson një të afërm sepse arsyetohen do gjëra por kjo është e tepërt për shkak se nuk punësohet personi dy muaj para se me u shpallur konkursi dhe këto gjëra janë të dëmshme për vendin

**Isni Bushi** thekson:- unë nuk potencova që është në rregull por unë potencova që janë organet që merren me atë.

**Nora Xhoni thekson:-** pasi jemi 9000 banorë nuk ka çka diskutohet sepse jemi gjithë familjarë dhe nuk kemi ku të shkojmë. Nepotizëm është kur janë 30 000 banorë e më shumë dhe atëherë është mundësia me pranuar më afër. Nëse hapet si temë ka me pasur probleme se do të përmendën emrat dhe nëse përmenden çdo kush do ta mbron të vetin.

**Kryesuesi thekson:-** është mirë të harmonizohen gjërat sepse po e shohë kërkesën e z.Mefail Suma si të padefinuar. Me potencuar nepotizmin ndoshta nuk kisha morë diskutim sepse nuk jam ekspertë për këtë lami por me potencuar nepotizmi në komunë ka tjetër kuptim dhe jam për me diskutuar për shkak se jam pjesë e kësaj.

**Mefail Suma thekson:-** unë e parandiejë se do të ketë përplasje dhe për me i ikur përplasjeve e shohë që ose do të mbrohet dikush ose do të sulmohet dikush. Unë dua t'i iki përplasjeve për shkak se jam në moshë dhe nuk kam kohë me i përmirësuar gabimet dhe unë mendoj se nuk jam gabim por propozimi është i imi dhe nuk dua tjetër kush të merret me këtë propozim sepse e kam propozuar unë. Unë prej sot e tërheq dhe ju diskutoni kur doni por unë dal prej mbledhjes.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** nuk e shohë që ka të keqe diçka kur diskutohet dhe nuk do të thotë që vetëm nepotizmi me u diskutuar si çështje negative dhe nuk do të thotë që ne marrim vendim por janë organet gjyqësore që merren nëse dikujt iu është bërë e pa drejtë. Si dukuri negative edhe nepotizmi edhe siguria dhe gjithçka që neve na intereson mund t'i diskutojmë , mirëpo kur diskutohen nuk do të thotë që marrim vendim dhe kemi me akuzuar dikend. Unë isha kanë pjesë e diskutimeve se si me zhdukur nepotizmin nëse ka dhe pse diskutohet nuk është jashtë ligjore sepse kuvendi është organ legjislativ. z.Mefail Suma potencojo që e tërheq propozimin por jemi me i diskutuar të gjitha çështjet që janë në interes të qytetarëve. Nuk do të thotë pse janë 9000 banorë dhe nuk duhet të diskutohet dhe nëse janë qoftë edhe 1000 banorë duhet të diskutohet se asgjë të keqe nuk ka.

**Florim Shkreta thekson:-** kur diskutohet për nepotizmin dikush mendon që janë punë të familjarizimit dhe nuk është nepotizmi vetëm familjarizmi i ngushtë. Rastin më të freskët e kemi te qendra e regjistrimit të automjeteve se komuna jonë i humbë dy vende të punës për shkak se personat të cilët janë të punësuar i merr prej një vendi të punës i dërgon me një vend të punës diku tjetër dhe në ato pozita ka mundur me u hapur konkurs prej ministrisë, e me u punësuar edhe dy qytetarë të komunës së Hanit të Elezit . Këtë gjëra janë që të shtijnë me diskutuar për nepotizmin dhe fmailjarizmin që do të thotë faktikisht vendi është i kapt. Është gjynah dikush prej këshilltarëve nëse këtë rast e duartroket.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

#### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Miratimi i kornizës afatmesme buxhetore 2020-2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 është në lartësi prej 2,742,095 €, ndërsa projekcionet për vitin 2021 janë në shumë prej 2,846,397 € dhe për vitin 2022 janë në shumë prej 2,958,963 euro. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2020, mjetet nga financimi qeveritar (granti i përgjithshëm, granti i arsimit dhe i shëndetësisë) janë në shumë prej 2,424,230 €, që shënojnë pjesëmarrje në shumë prej 88.41%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 317,865 € apo 11.59%. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2020 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje: Paga dhe mëditje 1,789,897 €, Mallra dhe shërbime 283,234 €, Shpenzime Komunale 57,832 €, Subvencione dhe transfere 66,000 € dhe Shpenzime kapitale 545,132 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- buxheti për komunën për vitin 2019-2022 është i mirë por i ka disa mangësi. Riparimi i rrugëve me kubëza betoni dhe ndriçimi publik që ishte planifikuar në shumë prej 30 000 € që mendoj se është një buxhet shumë i madh dhe mendojë që këto mjete me u dedikuar me ndonjë projekt tjeter ku më shumë ka vlerë për shkak se ndriçimi publik në shumë vende nuk është funksional. Te çështja e ujit duhet të bëhet një zgjidhje sa më e shpjet për shkak se Hani i Elezit nuk ka ujë të pishëm. Për fshatin Paldenicë është mirë të gjendet një burim i ujit për shkak se uji është shumë i dëmshëm. Është përmendur që do të bëhet rregullimi i ndërtesave sociale por ku do të bëhet ai ndërtim. Çështja e trenit te projekti Bllaca 99 e keni parë se në çfarë gjendje është bërë për shkak se ende vizitorët nuk e kanë vizituar është bërë në gjendje shumë të keqe. Çka planifikoni me bërë te çështja e trenit? Te çerdhja e fëmijëve nëse hapet është mirë me pasur edhe pedagogë.

**Florim Shkreta** thekson:- mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë paraparë njëmbëdhjetë mbledhje por në kornizë janë planifikuar gjashtë mbledhje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- a kanë përshtatshmëri objektivat e kryetarit të komunës me planet që vijnë sipas viteve me buxhetin sepse shohë disa objektiva që përcillen pëershruhen dhe nuk realizohen. Është paraqitur shumë herë përkrahja e OJQ-ve dhe nuk e di se çka është realizuar. Subvencionimi në bujqësi a keni parasysh se cilat janë prioritet me i ndarë prioritetet? Uji i pishëm askund nuk shihet që është objektivë me prioritet. Ka disa pika që po bëhen më shumë sa me diskutuar në kuvend dhe nuk por realizohen.

**Isni Bushi** thekson:- faqe shtatë shihet që për çdo vit numri i nxënësve është duke u pakësuar dhe kjo çështje vërehet edhe në shkollën tonë por potencoitet se kanë bërë apel si MASHT të cilët kanë kërkuar nga komunat që me rastin e pensionimit të mos shpallin konkurs për pranim të kuadrit të rinj por nëpër ato vende të plotësohen me arsimtarët të cilët nuk e kanë fondin e plotë të orëve. A është diskutuar kjo çështje në ministri se si mund të zëvendësoshet një arsimtarë i një lëmije me një lëmi tjeter?

**Rufki Suma** thekson:- sa i përket pyetjeve të ndryshme të cilat u parashtruan e para ishte për ndriçimin publik që është bërë aty ku ka pasur mundësi dhe në këtë vit është në procedura të tenderimit për me u vazhduar. Problemin e ujit çdo herë e kemi përmendur dhe sivjet e ka marr përsipër “Bifurkacioni” dhe për këtë arsyë nuk është në objektivat e viteve të tjera çështja e ujit, mirëpo projektet kapitale të çështjeve të ujit mbeten të komunave. Shumica e kubëzimeve është kryer por ka me pasur nevojë çdo herë sepse krijohen vendbanime dhe lagje të reja. Në Plan Zhvillimore Komunal parashihet ndërtim sociale te pronat e ish armatës mbi magjistrale përballe shkollës filllore ‘Ilaz Thaçi’ . Në momenti që kanë përfunduar punimet për objektin e çerdhes kemi bërë kërkessë me shkrim në ministrinë përkatëse por nuk ka hyrë në planifikimet e vitit 2019, mirëpo në bisedën që e kemi pasur me Ministrin e Financave është premtuar që në buxhetin për vitin 2019 do të planifikohet çerdhja e fëmijëve me numrin e punëtorëve që i parashev ligji. Sa i përket pranimit të punëtorëve me ligj është e definuar pranimi i punëtorëve dhe ashtu siç e parashev do të bëhet pranimi i punëtorëve . Është vetëm një pedagog që punon për krejt shkollat për shkak se nuk ka kushte dhe hapësirë që Hani i Elezit me pasur më shumë për shkak se i ka vetëm tre shkolla filllore dhe një shkollë të mesme. Çdo herë jemi munduar me i përshtatur objektivat tona për me i realizuar dhe është shumë e vërtetë se një qind për qind çdo herë nuk realizohen objektivat, mirëpo shumica

e objektivat që ishin në objektivat e komunës janë realizuar dhe do të realizohen. Për subvencione në bujqësi për çdo vit e kemi paraparë se ku ka pasur nevojë me shtuar dhe para se me marr vendim për subvencionim i vlerësojmë se cilat kategori ka pasur nevojë. I kemi subvencionuar mjedrat për shkak se ka rënë çmimi, kurse bletarët nuk i kemi subvencionuar për shkak 20 € po e shesin një kilogram mijaltë dhe kanë përfitim të mirë. Më mirë do të ishte me i ndihmuar ata të cilëve ju kanë dëmtuar bletët prej ariut sepse potencohejt në bazë të ligjit që nuk mundet të vritet ariu kurse ministria nuk i kompenzonë dëmet të cilat bëhen prej ariut. Sa i përket grantit specifik që u përmend te arsimi realiteti është se në krejt Kosovën ka rënje të madhe të nxënësve. Ministria e arsimit për mos me i larguar arsimtarët nga puna ka rekomanduar në atë formë.

**Refet Kalisi** thekson:- ndriçimi publikë është funksional dhe ndoshta mund të ndodhë që ndonjë drithë nuk funksionon. Mjetet financiare janë planifikuar për atu rrugë të cilat nuk kanë ndriçim.

**Shabi Rexhallari** thekson:- sa i përket mbledhjeve të Komitetit për Komunitete do të shikojmë me sekretarin se si janë planifikuar në mënyrë që me i planifikuar mjetet financiare.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çështja e ujit të pishëm nuk është problem vetëm në Han të Elezit sepse banorë kemi edhe nëpër fshatra dhe askund nuk potencohejt zgjidhja e problemit të ujit nëpër fshatrat që kanë problem dhe gjithë e dimë që nuk ka objektivë dhe prioritet për këtë dhe ne jemi fokusuar në Han të Elezit. Te uji i pishëm i bien sikur tash "Bifurkacioni" e ka në menaxhim dhe sikur komuna ka paguar persona më herët këtë që nuk paskan me menaxhuar diç është një problem këtu. Probleme me ndriçimin ka dhe nuk ka funksionuar edhe aq mirë dhe në mënyrë specifike po e potencojo te "Varrezat e Dëshmorëve" që ka probleme të shumta me ndriçimin sepse 100 drita kanë dalur prej përdorimin dhe aty është një shkaktarë. Unë kam propozuar që të vendoset një trafo dhe janë procedurat që duhet komuna me i kryer. Kryetari pat potencuar që ka me u lidhë me Hanin e Elezit por po më dogat më shumë ka qenë fushatë dhe është mirë me jetësuar këtë. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugicave të betonit ka rrugica të cilat janë shtruar në vitin e kaluar dhe në këtë vit janë dëmtuar dhe nuk e di si i keni paraparë me i rregulluar.

**Florim Shkreta** thekson:- ka ankesa prej qytetarëve për shkak të pagesës sepse ndoshta orëmatësit nuk janë në rregull apo ndoshta problem paraqet ajri. Është e vërtetë që ndoshta kubëzat çdo vit kanë nevojë me u riparuar sepse ka nevojë por kryetari i komunës pak i ka hapur krahët sepse po shtron edhe oborre private dhe nuk është mirë që me taksa paguesit e qytetarëve me bërë fushatë .

**Besarta Suma** thekson:- uji i pijes që është me pagesë, a është i pishëm për shkak se na nuk e përdorim ujin e qytetit? Qytetarët të cilët po e paguajnë ujin ndoshta janë të zhgënjer se edhe me paguar edhe mos me pijë . Kur mendoni me zgjidhë problemi për ujin e pijes.

**Mefail Suma** thekson:- fshati Dimcë nuk ka problem me ujë të pijes por problemi më të madh e kemi me fshatin Dërmjak për shkak se me marrëveshje e kanë pasur ujin gjysmën Dermjaku, gjysmën Dimca. Kemi vendos gypa por ata po i zanë. Shpesh Hani i Elezit vjen e ndanë ujin dhe Dimca çdo herë e ka përkrahur Hanin e Elezit që mos me mbetur pa ujë. Unë e kam shpërndarë edhe në fesbuk dhe mendimi imë është te "Mulliri Ilazit" me bërë pus dhe me vendosë një pengesë dhe akumulohet uji dhe mund të përfshihet Dimca, Dermjaku, Paldenica, Seçishta, Lagjja Meliq. Është mirë që të punohet në këtë drejtim.

**Teuta Shkreta** thekson:- banorët të cilët nuk e përdorin ujin përmes rrjetit të ujësjellësit a përfshihen në pagesë . Ndriçimi duhet të vendoset prej te kufiri deri te hekurudha për shkak se është shumë i nevojshëm.

**Rufki Suma** thekson:- nuk paguajnë ujë ata të cilët nuk e shfrytëzojnë , kurse ata të cilët kanë vendosur orëmatës dhe kanë bërë kontratë dhe nëse nuk shpenzojnë e paguajnë vetëm taksën dhe ata të cilët duan me u shkëputur prej "Bifurkacionit" e kryen borxhin dhe e njofton kompaninë që dua me u hekë. Për çdo vit kemi bërë Hulumtimin nëpër fshatra për ujin e pijes dhe nuk të bëjmë furnizimin me ujë pa e ditur hulumtimin. Rrugica me kubëza betoni kemi shtruar ku janë rrugët publike por ju e dini që një pjesë e madhe e rrugicave dhe e rrugëve janë në pronësi të qytetarëve. Kushti për me shtruar një rrugë është që banorët me u deklaruar me nënshkrime dhe

deklarohen se kjo rrugë do të jetë publike. Kompanitë të cilat i shtrojnë rrugicat e kanë afatin ligjorë që brenda një viti me mirëmbajtur rrugicën nëse dëmtohet. I vetmi vend është te "Mulliri i Ilazit" që mundet me u bërë si lige artificialë ose me u bartur me gypa. Këtë e kemi biseduar me organizata të ndryshme por ende nuk kemi bërë diçka konkrete. Është e vërtetë që gjithmonë Dimca është bërë kurban i Dermjakut për shkak se shumë herë kanë bërë probleme kur është ndalur uji Dimcka ka hequr dorë prej pjesës vetëm me marrëveshje që e kanë pasur me shfrytëzuar për ujitje, kurse te Dermjaku nuk ka pasur mirëkuptim gati asnjëherë përjashtimisht për Festën e Bajramit. Për rregullimin e trafo KED-si ka premtuar që do ta bënë sepse është e vërtetë që ka probleme tensioni.

**Florim Shkreta thekson:-** u potencua që rrugë private nuk kam shtruar dhe unë besoj që ka shtruar dhe e ke kryesuesin e kuvendit aty ngat i cili e ka privat rrugën dhe ja ke shtruar por ka edhe shumë të tjera. Si mund të llogaritet një rrugë publike e cila i ka 50 metra gjatësi, e është qorr sokak dhe nuk ka dalje. I thuhet bane publike dhe unë e shtrojë që do të thotë je duke ja shtruar militantit tuaj apo argatit tuaj me mjete financiare të taksa paguesve dhe kjo nënkuftohet që është fushatë .

**Kryesuesi thekson:-** me i pas kërkuar kubëzat e vjetra t'i kishim dërguar dhe është mirë që i kanë menaxhuar.

**Florim Shkreta thekson:-** kryetari shtiret që i donë familjet e dëshmorëve dhe ka familje që rrugën e ka të pa asfaltuar për shkak se është rrugë private dhe unë mendojë përparesi ka pasur ajo familje.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 8 për, 4 abstenim (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATUA KORNIZA AFAT MESME BUXHETORE PËR VITIN 2019-2022

### 3. Miratimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri thekson:-** rregullorja i ka kaluar të gjitha procedurat dhe është përcjellur për miratim në kuvend. nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma thekson:-** në shkresë përcjellëse shënon shqyrtimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë , kurse në rend dite shënon miratimi i rregullores për transparencë. Te dispozitivi është shënuar Standardet Minimale të Konsultimit Publik të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të dispozitave të nenit 79 të statutit të komunës 01 Nr.7703 të datës .25.10.2018 për konsultim me publikun. Kërkoj sqarim se nuk po e kuptojë mbështetjen. Neni 22.1 është shënuar komunat obligohen që të hartojnë Planet Vjetore të Punës se Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit. Duhet të jetë komuna obligohet. Duhet të përmirësohen dhe të jetë komuna obligohet për shkak se janë shënuar në shumës. Te neni 24.3. që është plani duhet të përfshijë, të jetë edhe mbledhjet e këshillit të drejtoreve. A ka kaluar nëpër komision kjo rregullore për shkak se nuk keni shënuar asgjë? U potencua që është mbajtur debati publik por kërkojë të dijë se në cilën datë është mbajtur debati publik dhe sa ka qenë numri i pjesëmarrësve?

**Mehmet Ballazhi thekson:-** faqe katër pika 6.6 nëse një fshat, vendbanim apo lagje, ka më pak se 4 500 banorë të regjistruar në listat e votuesve, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë XX % të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve. Është mirë të përcaktohet përqindja e banorëve sa duhet të jetë. Unë propozoj që kjo rregullore t'i kthehet komisionit në mënyrë që ta shqyrtojë dhe të merren për bazë të gjitha sugjerimet dhe këshillat e anëtarëve të kuvendit të komunës.

**Florim Shkreta thekson:-** faqja e komunës a është publike për të gjithë qytetarët apo është vetëm për zyrtarët komunal. Ju potenconi se transmetimi i mbledhjeve është i ndaluar , mirëpo mbledhjen solemne u transmetua direkt në fesbuk . kërkoj sqarim për këtë çështje?

**Kryesuesi thekson:-** gabimet të cilat janë duhet të përmirësohen, ndërsa nuk jam për me kthyer sepse i ka kaluar të gjitha procedurat dhe gabimet teknike përmirësohen. Këtë çështje mund ta parashtroni te të ndryshmet për shkak se jemi duke proceduar rregulloren.

**Nuriman Kuka thekson:-** gabimet u potencua që janë teknike dhe mund të përmirësohet dhe është mirë që ta miratojë si pikë të rendit të punës dhe pastaj gabimet ne t'i përmirësojnë.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** edhe nëse miratohet kjo rregullore nuk gjen zbatim edhe pse ka pikë të mira që janë paraqitur. Anëtarët e tjerë të kuvendit edhe pse e kanë lexuar rregulloren nuk duan me diskutuar sepse nuk ka transparencë. Në dëgjim publik vetëm ata të cilat janë të punësuar në administratë kanë marr pjesë në mënyrë që mos me dalë numri i dobët i pjesëmarrësve në dëgjim publik. Komuna është dashur me marr masa që me bëre një sensibilizim që me marr pjesë qytetarët për shkak se ka të bëjë me transparencë.

**Bajrush Laçi thekson:-** mbledhjet e këshillit të drejtoreve nuk duhet të hynë si pikë për shkak se mbledhjet e bordit të drejtoreve nuk janë të shënuara me ligj por më bordi ka vetëm mbledhje konsultative dhe nuk është sikur komitete konsultative që janë të përcaktuara me udhëzim administrativ dhe me rregullore.

**Mefail Suma thekson:-** atëherë rrjedhë se kjo rregullore është për punën e kuvendit dhe trupat e tyre dhe ku është transparenca tjeter. E kam lexuar rregulloren e Prizrenit, të Prishtinës dhe asnjë nuk është e njëjtë për shkak se a e di se çfarë transparence ka te uzurpimi i pronave ndërsa në këtë rregullore nuk përmendet asgjë. Nuk është shkelje ligjore se çka ka diskutuar bordi i drejtoreve dhe i bien që ekzekutivi nuk ka kurfar transparence.

**Nora Xhoni thekson:-** sa i përketë numrit të banorëve te neni 6.6 besojë që janë bazuar diku dhe ndoshta janë bazuar në numrin e regjistrimit të fundit të banorëve.

**Bajrush Laçi thekson:-** këtë rregullore e ka punuar kolegium i transparencës dhe janë profesional për këtë çështje, mirëpo kur është dërguar nëpër komuna është dashur me u precizuar për komunat specifike. Te neni 6.6 potencoitet më pak se 4500 banorë në vend qëndrime apo në vendbanime dhe duhet të përcaktohet përqindja për me nënshkruar një peticion. Unë propozoj që përqindja të jetë 20 % .

**Edon Curri thekson:-** debati publik është mbajtur me datë 18.06.2019 por pjesëmarrjen saktë nuk e di me shifra.

**Kryesuesi thekson:-** propozimet i hedhë në votim rezultati i votimit ishte 9 për dhe 4 abstenim. Në tërësi e hedh në votim rregulloren 9 për , 1 kundër , 3 abstenim. (prezent ishin 13 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### **U MIRATUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TRANSPARENCE.**

#### **4. Informatë për sektorin e emergjencave.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Refet Kalisi thekson:-** në këtë gjashtë mujorë nuk kemi pasur vërvshime apo zjarre . materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Nora Xhoni thekson:-** në këtë informatë a është dashur me hyjë rasti i fëmijës të cilin e kafshoi ujku

**Refet Kalisi thekson:-** kjo informatë më shumë ka për qëllim me ju informuar për zjarre dhe për vërvshime apo për ndonjë katastrofë të madhe.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** rasti ujkut dhe i ariut që ka qenë në Han të Elezit mund të jetë fatkeqësi e madhe sepse një jetë njeriu është pasojë shumë e madhe

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 5. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- ligji është miratuar në vitin e kaluar por ministria ende nuk i ka proceduar udhëzimet administrative por jemi në pritje të këtyre udhëzimeve dhe nuk kemi informacion se kur do të miratohen.

Sabedin Hasallari thekson:- sa objekte të ndërtimit janë me leje?

Nexhmedin Daci thekson:- ky regjistrim është bërë në vitin 2013.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nuriman Kuka thekson:- është mirë të vendosen flamuj të ri për shkak se ishin dëmtuar te “Eksodi 99” .

Nexhmedin Daci thekson:- nuk është projekti i jonit por ai projekt është në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe e kanë obligim me rregulluar.

Florim Shkreta thekson:- kërkoj përgjigje me shkrim taksat që i ka kryer kompania “Elektra” për rrjetin kabllorë prej se ka filluar.

Mefail Suma thekson:- kërkoj përgjigje me shkrim që të sillet lista esenciale e barnave që i furnizon komuna për QKMF në mënyrë tabelare me çmim kushtues, hyrja dalja, gjendja për gjashtë mujorin fundit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendorit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:29

Procesmbajtësi

Avni Bushi

